



TOWER SH.P.K.



iGROUP SH.P.K.

RELACION

NDËRTIMI I HAPËSIRËS PUBLIKE MULTIFUNKSIONALE DHE PARKIMIT NËNTOKËSOR NË SHESHIN NËNË TEREZA BASHKIA TIRANË

PROJEKT TEKNIK

POROSITËS:

FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT

PËRGATITUR:

TOWER SH.P.K. & iGROUP SH.P.K.



1 HYRJE

Tirana, kryeqyteti i Shqipërisë, është qyteti më i madh dhe më i populluar në vend, me mbi 600,000 banorë dhe mijëra vizitorë që vijnë çdo ditë për punë, studime apo turizëm. Sheshi “Nënë Tereza” përfaqëson një nga hapësirat më ikonike dhe përfaqësuese të Tiranës, si në aspektin urbanistik ashtu edhe në atë simbolik. Ky pozicion e bën atë jo vetëm një pikë referimi vizuale të qytetit, por edhe një qendër të gjallë të jetës publike.

Dokumenti në vijim paraqet konceptet kryesore të aplikuara në hartimin e idesë paraprake të projektit për krijimin e një hapësire publike multifunksionale dhe të një parkimi nëntokësor në Sheshin “Nënë Tereza”, Bashkia Tiranë. Në aspektin praktik, projekti propozon:

- Rikthimin e sheshit në një hapësirë të dedikuar për këmbësorët, përmes rikonceptimit hapësinor dhe volumor.
- Krijimin e një Kapelje të dedikuar Nënë Terezës, si një destinacion i rëndësishëm fetar, vend ndalese për lutje, meditim ose nderim të figurës së shenjtore.
- Krijimin e hapësirave të shërbimit për vizitorët, turistët dhe përdoruesit e tjerë të sheshit.
- Krijimin e një parkimi nëntokësor nën hapësirën e re këmbësore të sheshit.
- Krijimin e një muzeu arkeologjik të vendosur nëntokë, poshtë nivelit të parkimit të ri.

Rëndësia e rikthimit të Sheshit “Nënë Tereza” në një hapësirë publike tërësisht të dedikuar për këmbësorët dhe vizitorët qëndron në potencialin e tij për të rigjallëruar jetën urbane dhe për të rikthyer dimensionin njerëzor të qytetit. Reduktimi i trafikut të automjeteve dhe krijimi i një mjedisi të sigurt e mikpritës do ta transformonin këtë shesh në një hapësirë të jetueshme, ku qytetarët mund të ecin, të pushojnë, të socializohen dhe të marrin pjesë në aktivitete kulturore dhe publike.

Një ndërhyrje e tillë do të forconte identitetin e Tiranës si një kryeqytet modern evropian, duke vendosur në qendër njerëzit dhe jo automjetet, si dhe do të rikthente ekuilibrin ndërmjet trashëgimisë monumentale të bulevardit historik dhe funksioneve bashkëkohore të qytetit. Në këtë mënyrë, Sheshi “Nënë Tereza” mund të shndërrohet në një hapësirë unifikuese, që pasqyron dinjitetin, kujtesën dhe energjinë e përditshme të qytetit.

2 POZICIONI I SHESHIT NËNË TEREZA

Sheshi “Nënë Tereza” zë një pozicion strategjik në skajin jugor të Bulevardit “Dëshmorët e Kombit”, boshti kryesor historik dhe ceremonial urban i qytetit të Tiranës. Sheshi formon një hapësirë të madhe publike të hapur me përmasa afërsisht 95 × 110 metra, duke përfshirë edhe zonat përreth të dedikuara për këmbësorët. Ai kufizohet në jug nga Universiteti Politeknik i Tiranës, në perëndim nga rruga “Lek Dukagjini”, e cila lidhet me rrethrotullimin e Sheshit “Frederik Chopin”, në lindje nga Instituti i Arkeologjisë dhe Sheshi “Italia”, ndërsa në veri nga Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”.

Sheshi përbën një nga hapësirat urbane më të rëndësishme të kryeqytetit, duke funksionuar njëkohësisht si pikë qendrore simbolike dhe fizike brenda strukturës urbane të qytetit. Vendndodhja

e tij në fundin monumental të bulevardit forcon rolin përfaqësues të tij, duke shërbyer si një vend i rëndësishëm për grumbullime publike, aktivitete kulturore, veprimtari akademike dhe ceremoni qytetare.

Historikisht, zona mori konfigurimin e saj aktual urban gjatë fazave të përgatitjes dhe zbatimit të planit rregullues të Tiranës të vitit 1940. Në atë periudhë, segmenti jugor i bulevardit ku ndodhet Sheshi “Nënë Tereza” njihej me emrin “Viale dell’Impero”. Ansambli i ndërtesave përreth — duke përfshirë stadiumin, “Casa del Fascio” (sot Universiteti Politeknik i Tiranës), “Opera Dopolavoro Albanese” (sot Muzeu Arkeologjik) dhe “Gioventù del Littorio Albanese” (sot Universiteti i Arteve) — u konceptua sipas parimeve të urbanistikës racionaliste italiane. Organizimi i tyre krijonte një kompozim simbolik të lidhur me “fascio littorio”, një nga simbolet më përfaqësuese të periudhës së fashizmit italian.

Përtej rëndësisë së saj historike, sheshi përfiton nga një kontekst unik peizazhor. Në jug, pas godinës së Universitetit Politeknik, shtrihen sipërfaqet e pyllëzuara të Parkut të Madh të Tiranës, të cilat depërtojnë vizualisht drejt qendrës së qytetit dhe krijojnë një sfond natyror që përmbyll boshtin monumental të Bulevardit “Dëshmorët e Kombit”. Kalimi gradual nga struktura urbane e dendur e bulevardit drejt gjelbërimit të parkut gjeneron një nga panoramat urbane më të njohura të Tiranës.

Kjo marrëdhënie ndërmjet arkitekturës, hapësirës së hapur dhe peizazhit krijon një siluetë karakteristike që përcakton perspektivën jugore të bulevardit dhe kontribuon në mënyrë të konsiderueshme në identitetin e qytetit. Për rrjedhojë, Sheshi “Nënë Tereza” përfaqëson jo vetëm një hapësirë publike të rëndësishme, por edhe një pikë kyçe referimi urbane, ku trashëgimia historike, funksionet institucionale dhe vlerat peizazhore bashkohen në një kompozim të vetëm monumental.



Pozicioni i Sheshit Nene Tereza – ASIG 2026

Territori i Sheshit “Nënë Tereza” karakterizohet nga një konfigurim i hapur dhe pa pengesa, i cili mundëson përdorimin fleksibël të tij si nga këmbësorët ashtu edhe nga automjetet. Falë pozicionit strategjik dhe përmasave të konsiderueshme, sheshi shërben si një hapësirë publike e rëndësishme që akomodon një gamë të gjerë aktiviteteve urbane, ngjarjesh institucionale dhe tubimesh qytetare.

Në qendër të sheshit, në vendin ku më parë ndodhej struktura historike e shatërvanit, aktualisht gjendet një sipërfaqe e shtruar në formë platforme, e ngritur një shkallë mbi nivelin e zonës përreth. Kjo platformë e ngritur është shndërruar në një hapësirë publike multifunksionale dhe përdoret shpesh si vend për zhvillimin e aktiviteteve kulturore, artistike, edukative dhe sportive. Pozicioni i saj i ngritur krijon natyrshëm një pikë fokale brenda sheshit, duke mundësuar organizimin e instalacioneve të përkohshme, performancave publike, ekspozitave, ceremonive dhe aktiviteteve të ndryshme komunitare.



Pamje e pjesshme e Sheshit Nene Tereza_Korrik 2026

3 KONCEPTI ARKITEKTONIK

Kompozimi arkitektonik propozon një riorganizim tërësor të hapësirës së Sheshit “Nënë Tereza”, duke rikonceptuar skemën e lëvizjes së automjeteve në shesh, si dhe duke propozuar një sërë funksionesh të reja të organizuara në tre nivele nëntokësore poshtë sheshit ekzistues, të përcaktuara sipas funksioneve përkatëse që ato do të akomodojnë.

3.1 RIKOMPOZIMI I SHESHIT – HAPËSIRA MULTIFUNKSIONALE

Ndërhyrja propozon riorganizimin hapësinor të Sheshit Nënë Tereza përmes transformimit të kontrolluar të kuotës së tij horizontale dhe krijimit të një niveli të ri publik në kuotën -4.00 m. Koncepti shmang vendosjen e volumeve të theksuara mbi tokë dhe e zhvillon programin kryesisht në nëntokë, me synim ruajtjen e vazhdimësisë urbane, perceptimit monumental dhe karakterit të hapur të sheshit.

Zgjidhja arkitektonike bazohet në formimin e një hapësire të zhytur me gjeometri poligonale, e konceptuar si një prerje e kontrolluar në platformën ekzistuese. Kjo hapësirë funksionon njëkohësisht si shesh i ulur, zonë hyrëse dhe element shpërndarës drejt funksioneve kulturore, muzeale dhe publike të zhvilluara në nivelet nëntokësore.

Lidhja ndërmjet kuotës së sheshit dhe nivelit -4.00 m realizohet përmes rampave, shkallëve dhe elementeve vertikale të qarkullimit, të integruara në kompozimin e përgjithshëm. Sekuenca e zbritjes trajtohet si pjesë e përvojës arkitektonike, duke mundësuar kalimin gradual nga hapësira urbane e hapur në ambientet e kontrolluara të programit nëntokësor.

Gjeometria e pastër, kufizimi i elementeve mbi sipërfaqe dhe përdorimi i fasadave transparente përgjatë hapësirës së zhytur synojnë të ruajnë lidhjen vizuale ndërmjet dy niveleve, të sigurojnë ndriçim natyror dhe të përmirësojnë orientimin e përdoruesve.

Ndërhyrja integrohet në strukturën ekzistuese të sheshit pa cenuar akset urbane dhe marrëdhëniet vizuale me objektet monumentale përreth. Në këtë mënyrë krijohet një sistem hapësinor i shtresëzuar, ku sipërfaqja ruan funksionin e saj përfaqësues dhe qytetar, ndërsa niveli i poshtëm përmban programet e reja publike dhe kulturore.



Pamje tre dimensionale e propozuar e sheshit te rikonceptuar

Elementi qendror i ndërhyrjes është krijimi i një sheshi publik të zhytur, të organizuar në një kuotë të ndërmjetme në nivelin ekzistues të Sheshit Nënë Tereza. Kjo hapësirë konceptohet si një platformë multifunksionale, e aftë të akomodojë aktivitete kulturore, sociale dhe rekreative, si dhe të funksionojë si zonë hyrëse dhe shpërndarëse për programet e zhvilluara në nivelet nëntokësore.




Pamje e propozuar tre dimensionale e transformimit te sheshit

Sheshi i zhytur realizohet përmes një “prerje” të kontrolluar në sipërfaqen ekzistuese, duke e trajtuar planin horizontal të sheshit si element aktiv të kompozimit arkitektonik. Gjeometria e ndërhyrjes

është e pastër dhe e përmbajtur, me synim integrimin e saj në strukturën urbane ekzistuese dhe ruajtjen e aksialitetit, monumentalitetit dhe marrëdhënieve vizuale me objektet përfaqësuese përreth.

Lidhja ndërmjet kuotës ekzistuese dhe nivelit të zhytur realizohet nëpërmjet sipërfaqeve me pjerrësi të kontrolluar, rampave dhe shkallëve të integruara në konfigurimin e përgjithshëm. Këto elemente sigurojnë vazhdimësinë e qarkullimit këmbësor, aksesueshmërinë universale dhe një kalim gradual ndërmjet dy niveleve, duke shmangur perceptimin e hapësirës së ulur si një element i shkëputur nga sheshi.



Skema e propozuar hapësinore e sheshit ne kuoten ± 0.00


Trajtimi i skajeve zbritëse kontribuon në krijimin e një marrëdhënieje të drejtpërdrejtë vizuale dhe funksionale ndërmjet sipërfaqes dhe hapësirave nëntokësore. Në këtë mënyrë, sheshi i zhytur perceptohet si vazhdim i platformës publike ekzistuese dhe jo si një oborr i izoluar, duke ruajtur karakterin e hapur dhe qytetar të ndërhyrjes.

Kompozimi formal mbështetet në përdorimin e linjave të pastra, planeve të vazhdueshme dhe elementeve ndërtimore të reduktuara. Materialiteti parashikon përdorimin e gurit natyror me karakteristika të përafërta me veshjen ekzistuese të sheshit, duke garantuar vazhdimësi vizuale dhe integrim të kontrolluar në kontekst.

Sipërfaqet transparente dhe reflektuese, të kombinuara me orientimin dhe ekspozimin e hapësirës së zhytur, mundësojnë depërtimin e ndriçimit natyror në nivelet e poshtme. Variacionet e dritës dhe hijes gjatë ditës evidentojnë gjeometrinë e ndërhyrjes, përmirësojnë perceptimin hapësinor dhe reduktojnë karakterin e mbyllur të programit nëntokësor. Në tërësi, zgjidhja krijon një ekuilibër ndërmjet shkallës monumentale të sheshit dhe dimensionit njerëzor të hapësirës së re publike, duke integruar programet e propozuara pa cenuar identitetin urban dhe arkitektonik të Sheshit Nënë Tereza.

Ndërhyrja projektohet në raport të drejtpërdrejtë me strukturën monumentale dhe institucionale që përcakton Sheshin Nënë Tereza, veçanërisht me godinën e Universitetit Politeknik të Tiranës dhe ndërtesat universitare përreth. Zhvillimi kryesisht nëntokësor dhe kontrolli i elementeve mbi kuotën e sheshit mundësojnë ruajtjen e dominancës vizuale të objekteve ekzistuese, të akseve kompozicionale dhe të profilit urban të hapësirës.


Propozimi nuk trajtohet si objekt autonom, por si pjesë integrale e sistemit të hapësirës publike. Minimizimi i volumetrisë mbi tokë ruan vazhdimësinë perceptuese të sheshit, forcon hierarkinë ndërmjet platformës publike dhe fasadave institucionale, si dhe shmang konkurrencën formale me arkitekturën monumentale ekzistuese.



Aksonometria e propozuar e sheshit të ri

Nga pikëpamja urbanistike, ndërhyrja synon rritjen e intensitetit dhe diversitetit të përdorimit të sheshit përmes integritetit të funksioneve kulturore, edukative, sociale dhe rekreative. Organizimi i këtyre programeve në nivelet nëntokësore lejon zgjerimin e kapacitetit funksional të zonës pa ngarkuar siluetën urbane me volume të reja.

Konfigurimi i propozuar përmirëson lidhjet funksionale ndërmjet sheshit, institucioneve universitare dhe programeve të reja publike, duke krijuar kushte për përdorim të vazhdueshëm gjatë ditës dhe në periudha të ndryshme të vitit. Në këtë mënyrë, ndërhyrja konsolidon rolin e Sheshit Nënë Tereza si hapësirë përfaqësuese, qytetare dhe kulturore, duke ruajtur njëkohësisht identitetin e tij historik dhe institucional.



Skema e shpërndarjes së funksioneve në nivelin -4 metra.

3.2 SHATËRVANET

Në sheshin në nivelin 0.00 janë parashikuar tre hapësira ku do të instalohen shatërvane. Në nivelin ± 0.00 , shatërvanet janë konceptuar si elementë integrale të kompozimit të ri të Sheshit “Nënë Tereza”, duke kombinuar funksionin estetik, klimatik dhe social të hapësirës publike. Ato nuk trajtohen si objekte të izoluara apo si basene tradicionale të ngritura mbi sipërfaqe, por si pjesë e vazhdueshme e shtresës së shtrimit të sheshit, në mënyrë që të ruhet karakteri i hapur dhe fleksibël i tij.

Zgjidhja parashikon shatërvane lineare dhe interaktive, me grykat e ujit të vendosura në të njëjtin nivel me sipërfaqen e sheshit. Kur sistemi nuk është në funksion, zona e shatërvanit mund të përdoret normalisht për lëvizjen e këmbësorëve, organizimin e aktiviteteve publike, ceremonive, ekspozitave të përkohshme apo eventeve me kapacitet të lartë. Kjo mënyrë organizimi mundëson një përdorim të shumëfishtë të hapësirës dhe shmang krijimin e barrierave fizike brenda sheshit.



Sistemi i ujit mund të realizojë skenarë të ndryshëm funksionimi, duke përfshirë rrjedhje të ulëta dhe të vazhdueshme gjatë përdorimit të përditshëm, impulse ritmike të kontrolluara, si dhe kompozime dinamike gjatë aktiviteteve kulturore ose ceremoniale. Kontrolli i pavarur i grykave lejon ndryshimin e lartësisë, intensitetit dhe ritmit të ujit, duke krijuar një element urban të gjallë dhe të ndryshueshëm.

Në periudhën e verës, shatërvanet kontribuojnë në përmirësimin e mikroklimës së sheshit përmes avullimit dhe freskimit lokal të ajrit. Prania e ujit redukton perceptimin e temperaturave të larta të sipërfaqeve të gurta dhe krijon zona më tërheqëse për qëndrimin, pushimin dhe ndërveprimin social. Karakteri interaktiv i tyre i bën këto hapësira veçanërisht të përshtatshme për fëmijët dhe familjet, duke rritur përdorimin e sheshit gjatë gjithë ditës.

Në orët e mbrëmjes, shatërvanet mund të kombinohen me ndriçim LED të integruar në dysHEME ose pranë grykave të ujit. Ndriçimi duhet të jetë i kontrolluar dhe i përmbajtur, në harmoni me karakterin monumental të sheshit. Preferohen tonalitete të bardha ose të ngrohta për përdorimin e zakonshëm, ndërsa ndryshimi i ngjyrave mund të rezervohet për evente të veçanta, festa publike ose aktivitete

3.3 HAPËSIRA E PRITJES DHE HYRJES SË MUZEUT ARKEOLOGJIK

E vendosur në anën lindore të sheshit, kjo hapësirë zë një sipërfaqe prej afërsisht 500 m² dhe shërben si pika kryesore e aksesit në muzeun arkeologjik. Objekti përfshin funksione pritjeje dhe orientimi për vizitorët, hapësira për biletari dhe informacion, ambiente administrative dhe operacionale të muzeut, si dhe hapësira fleksibël për aktivitete edukative, prezantime, seminare, punëtori dhe ekspozita të lidhura me artin, kulturën dhe trashëgiminë. Si pika e parë e kontaktit për vizitorët, kjo hapësirë krijon tranzicionin ndërmjet hapësirës publike të sheshit dhe mjedisit muzeal të zhvilluar në nivelet nëntokësore.

3.3.1 KAPELA E NËNË TEREZËS

Me një sipërfaqe prej afërsisht 700 m², integrimi i një kapeleje kushtuar Nënë Terezës përfaqëson një ndërhyrje me rëndësi të veçantë simbolike, kulturore dhe shpirtërore. Kapela pasuron identitetin e një prej hapësirave publike më përfaqësuese të kryeqytetit, duke krijuar një vend të dedikuar për reflektim, meditim dhe qetësi.

Vendosja e saj në nivelin e sheshit mbart një domethënie të fuqishme metaforike. Zbritja drejt kapeles shndërrohet në një udhëtim introspektiv, duke ofruar një shkëputje të përkohshme nga ritmi dhe intensiteti i jetës urbane dhe duke inkurajuar një lidhje më të thellë me dimensionin shpirtëror të vendit. Kjo sekuencë hapësinore krijon një kontrast të qëllimshëm ndërmjet hapësirës së hapur dhe dinamike të sheshit mbi tokë dhe atmosferës intime e medituese të kapeles poshtë tij.

Koncepti arkitektonik pasqyron vlerat e përlësisë, thjeshtësisë, dhembshurisë dhe shërbimit që karakterizuan jetën dhe veprën e Nënë Terezës, duke krijuar një hapësirë simbolike dhe njëkohësisht të aksesueshme për të gjithë vizitorët, pavarësisht besimit apo prejardhjes së tyre.



3.4 HAPËSIRA E BAR-RESTORANTIT

Një sipërfaqe prej afërsisht 340 m² është dedikuar funksioneve të shërbimit ushqimor dhe gastronomik. Integrimi i një bar-restoranti brenda sheshit të zhytur krijon përfitime të rëndësishme urbane, sociale dhe ekonomike, duke e transformuar hapësirën nga një mjedis kryesisht kalimtar në një destinacion aktiv gjatë gjithë ditës dhe mbrëmjes.

Brenda kuadrit më të gjerë të muzeut arkeologjik dhe funksioneve kulturore, bar-restoranti funksionon si një shërbim plotësues, duke ofruar mundësi për relaksim, ndërveprim social, takime informale dhe zgjatjen e kohës së qëndrimit të vizitorëve. Në institucionet bashkëkohore muzeale dhe kulturore në mbarë botën, hapësirat e mikpritjes konsiderohen gjithnjë e më shumë si komponentë thelbësorë të përvojës së vizitorit, duke kontribuar si në atraktivitetin ashtu edhe në qëndrueshmërinë ekonomike të destinacioneve kulturore.

4 SKEMA E LEVIZJES SË NJERËZVE


Lëvizja e vizitoreve të sheshit dhe të muzeut, është konceptuar në format si vijon:

- Sheshi i poshtëm në nivelin -4.00 do të aksesohet përmes dy rampave dhe dy shkalleve të mëdha, të organizuara sipas konceptit arkitektonik. Sheshi i poshtëm në këtë nivel mundëson shpërndarjen e vizitoreve nëpër të gjitha hapësirat funksionale të parashikuara si bar restoranti, Kapela e Nënë Terezës si dhe holli i muzeut arkeologjik. Po ashtu përmes këtij sheshi, vizitorët do të mund të aksesojnë parkimin nëntokësorë, përmes 4 kullonave të shkalleve dhe ashensoreve të dedikuara, të pozicionuar në 4 cepat e hapësirës.
- Hapësira e parkimit, e konceptuar në nivelin -7.75 do të aksesohet përmes:
 - Galerisë qarkuese nëntokësore që mundëson aksesin e vizitoreve me automjete
 - 4 kullonave të shkalleve dhe ashensoreve
- Hapësira e Muzeut Arkeologjik, e projektuar në dy nivele
 - Niveli I parë përfshin Hollin kryesor në nivelin -4.00, dhe përfshin edhe hapësira shërbimi ekstra, hapësira administrative si dhe një nyje tualeti për vizitorë dhe staf
 - Niveli I muzeut, i pozicionuar në nivelin -19.00 metra, do të aksesohet përmes 4 kullonave të shkalleve në 4 cepat e hapësirës si dhe përmes 3 ashensoreve standard, me kapacitet 600 kg për vizitorët
 - Përveç këtyre ashensoreve, është parashikuar edhe një ashensor i dedikuar për mallrat, me kapacitet 2000 kg, i cili mund të aksesohet nga holli, galeria e lëvizjes së automjeteve në nivelin -7.75 si dhe në çdo kat të hapësirave teknike dhe në nivelin përfundimtar të muzeut, në kuotën -19.00 metra.

5 RIKONCEPTIMI I SKEMËS SË LËVIZJES SË AUTOMJETEVE

Projekti propozon transformimin e sheshit në një hapësirë të dedikuar për këmbësorët, ku trafiku i automjeteve do të zhvendoset në nivelin e dytë nëntokësor, përmes tre rampave të dedikuara. Një rampë parashikohet në aksin qendror të Bulevardit “Dëshmorët e Kombit”, në segmentin ndërmjet Pallatit të Kongreseve dhe Presidencës. Ndërkohë, në pjesën jugore propozohen dy rampa të tjera, të pozicionuara në rrugën “Lek Dukagjini”, në të dy drejtimet perballë godinës së Korpusit Universitar. Të tre rampat janë me dy korsi lëvizjeje dhe janë projektuar me një pjerrësi prej 15%.


Të tre rampat lidhen me një skemë qarkullimi në formë unaze nëntokësore, të vendosur poshtë sheshit ekzistues. Në këtë mënyrë, trafiku i automjeteve që aktualisht kalon në sipërfaqen e sheshit transferohet në nëntokë, përmes krijimit të një unaze të dedikuar qarkullimi të mjeteve. Në qendër të kësaj unaze pozicionohet hapësira e parkimit nëntokësor. Si rezultat, automjetet do të kenë mundësi të aksesojnë parkimin përmes sistemit të qarkullimit të organizuar në unazën nëntokësore, duke garantuar funksionim efikas dhe minimizuar ndikimin e trafikut në hapësirat publike të sipërfaqes.



Prerje teknike e rampes së hyrjes së mjeteve në bulevardin Dëshmorët e Kombit

Korridori nëntokësor i trafikut është projektuar me dy korsi qarkullimi, secila me gjerësi 3.5 metra, duke siguruar kapacitet të mjaftueshëm për lëvizjen e qetë dhe të sigurt të automjeteve. Përveç karrexhatës së dedikuar për trafikun, në të dyja anët e korridorit janë parashikuar hapësira për lëvizjen e këmbësorëve.

Duke marrë parasysh natyrën e kontrolluar të mjedisit nëntokësor dhe fluksin e kufizuar të këmbësorëve që pritet në këtë infrastrukturë, këto kalime janë menduar kryesisht për lëvizje sporadike të personelit, akses mirëmbajtjeje, evakuim në raste emergjente dhe nevoja operationale, më shumë sesa për përdorim të vazhdueshëm publik. Kjo skemë garanton ndarjen e sigurt të qarkullimit të automjeteve nga ai i këmbësorëve, duke optimizuar njëkohësisht përdorimin e hapësirës së disponueshme nëntokësore.




Skema e propozuar për lëvizjen e mjeteve në sheshin Nënë Tereza

6 HAPESIRA E PARKIMIT NENTOKESOR

Parkimi nëntokësor është një nga elementet kryesore të programit të projektit. Kjo hapësirë e vendosur nën nivelin e sheshit të zhytur, konceptohet si një element i rëndësishëm i infrastruktures së bulevardit, zhvillimi i të cilit synon të reduktojë volumin e përgjithshëm të trafikut në zonën pranë sheshit Nënë Tereza. Përmes krijimit të kësaj hapësirë parkimi synohet orientimi i një mjedisi urban më të orientuar drejt këmbësorëve, duke përmirësuar kështu cilësinë, sigurinë dhe përdorshmërinë e hapësirave publike në qytet.

Sheshi i parkimit është projektuar sipas një skeme të qartë dhe efikase qarkullimi, e cila garanton njëkohësisht funksionalitet operacional dhe komoditet për përdoruesit. Organizimi i njësive të parkimit bazohet në një sistem modulesh të rregullta parkimi, të shërbyera nga korridore qendrore qarkullimi, duke mundësuar lëvizje të rrjedhshme të automjeteve, orientim intuitiv dhe manovrim efikas në të gjithë hapësirën e parkimit. Kjo konfigurim optimizon përdorimin e sipërfaqes së disponueshme, duke ruajtur standarde të larta aksesueshmërie, sigurie dhe funksionaliteti.



Skema hapësinore e propozuar e parkimit nëntokësor

Me një kapacitet total prej afërsisht 170 vendparkimesh, objekti është në gjendje të akomodojë një numër të konsiderueshëm vizitorësh, punonjësish, studentësh dhe turistësh që frekuentojnë institucionet dhe funksionet urbane të vendosura në zonën përreth. Projekti parashikon rrugë qarkullimi të qarta për automjetet, korridore të dedikuara për lëvizjen e këmbësorëve dhe lidhje të drejtpërdrejta me bërthamat e qarkullimit vertikal, duke garantuar akses të lehtë dhe efikas ndërmjet nivelit të parkimit, hapësirave publike mbi të, muzeut arkeologjik dhe funksioneve të tjera të kompleksit nëntokësor.

Parkimi nuk konceptohet si një strukturë infrastrukturore e izoluar, por si një komponent integral i kompleksit nëntokësor të zhvilluar nën Sheshin Nënë Tereza. Vendosja e tij poshtë hapësirës publike krijon një sërë përfitimesh të rëndësishme urbane dhe funksionale, ndër të cilat:

- Lirimin e sipërfaqes së sheshit nga zënia e automjeteve;
- Zgjerimin dhe përmirësimin e hapësirave publike të orientuara drejt këmbësorëve;
- Ruajtjen e karakterit monumental dhe përfaqësues të Sheshit Nënë Tereza;
- Krijimin e kushteve të favorshme për zhvillimin e aktiviteteve kulturore, sociale, edukative dhe turistike në nivelin e sipërfaqes.

Përmes kësaj qasjeje, funksionet e automjeteve transferohen në nëntokë, ndërsa sipërfaqja e sheshit mbetet plotësisht në dispozicion të këmbësorëve dhe jetës publike. Kjo strategji kontribuon në

mënyrë të drejtpërdrejtë në përmirësimin e përvojës urbane dhe në forcimin e rolit të sheshit si një nga hapësirat më të rëndësishme qytetare dhe kulturore të kryeqytetit.



Një nga karakteristikat kryesore të organizimit të parkimit është ndarja e qartë ndërmjet hyrjes dhe daljes së automjeteve, të pozicionuara në anë të kundërta të strukturës. Kjo konfigurim ofron disa përparësi të rëndësishme operationale:

- Eliminimin e konflikteve të trafikut brenda strukturës së parkimit;
- Rritjen e kapacitetit të përpunimit të automjeteve gjatë periudhave me kërkesë të lartë;
- Përmirësimin e sigurisë dhe lexueshmërisë së qarkullimit;
- Reduktimin e kohës së lëvizjes dhe minimizimin e kohës së nevojshme për gjetjen e një vendparkimi të lirë.

Rrjeti i qarkullimit të brendshëm organizohet përmes kombinimit të korsive perimetrale dhe korridoreve qendrore të trafikut, duke krijuar një sistem lëvizjeje të vazhdueshëm dhe shumë efikas. Kjo skemë optimizon aksesin në të gjitha zonat e parkimit dhe përmirëson ndjeshëm performancën operationale të objektit.

Aksesi i përdoruesve dhe evakuimi në raste emergjente garantojnë përmes bërthamave të qarkullimit vertikal të vendosura në mënyrë strategjike në katër qoshet e strukturës së parkimit. Këto bërthama përfshijnë ashensorë për pasagjerët, shkallë emergjence të mbrojtura dhe dalje të kontrolluara për këmbësorët, të cilat lidhen drejtpërdrejt me nivelin e sheshit. Përveç ofrimit të aksesit të përshtatshëm për vizitorët, këto elemente luajnë një rol themelor në përmbushjen e kërkesave të sigurisë, në mundësimin e procedurave të shpejta të evakuimit dhe në garantimin e aksesueshmërisë së plotë për të gjithë përdoruesit.



Prerja tërthore e propozuar e strukturës, ku parkimi nëntokësor shkon deri në nivelin -7.75 metra.

7 HAPËSIRAT E SHËRBIMIT DHE AMBJENTET TEKNIKE

Hapësirat teknike përbëjnë një komponent themelor të funksionimit të kompleksit nëntokësor dhe janë ideuar paralelisht me zhvillimin e konceptit arkitektonik dhe konstruktiv. Përqendrimi i tyre në nivelet e poshtme, ndarja sipas disiplinave dhe krijimi i akseve të dedikuara të shërbimit garantojnë funksionim të qëndrueshëm, mirëmbajtje të kontrolluar dhe ndërhyrje të sigurta. Hapësirat teknike të ndërhyrjes në Sheshin Nënë Tereza konceptohen si një sistem i integruar infrastrukture, i pozicionuar kryesisht në nivelet nëntokësore dhe i organizuar në mënyrë të tillë që të mbështesë funksionimin e hapësirave publike, muzeale, kulturore, liturgjike dhe të parkimit.

Zgjidhjet e propozuara synojnë që të gjitha sistemet teknike të funksionojnë si një infrastrukturë e integruar dhe sa më pak e perceptueshme nga përdoruesit e sheshit. Në këtë mënyrë ruhet karakteri monumental dhe publik i Sheshit Nënë Tereza, ndërsa sigurohen kushtet teknike të nevojshme për funksionimin e hapësirave të reja kulturore, publike dhe nëntokësore. Organizimi teknik synon të shmangin praninë e pajisjeve dhe elementeve ndihmëse mbi kuotën e sheshit, duke ruajtur vazhdimësinë e platformës publike, karakterin monumental të hapësirës dhe marrëdhëniet vizuale me objektet institucionale përreth.

Ambientet teknike vendosen në zona me akses të kontrolluar, të ndara nga qarkullimi publik dhe të lidhura me korridore shërbimi, akse vertikale dhe rrugë teknologjike të dedikuara. Pozicionimi i tyre merr në konsideratë kërkesat për mirëmbajtje, zëvendësimin e pajisjeve, ventilimin, sigurinë nga zjarri, mbrojtjen nga uji dhe kontrollin e zhurmës.

7.1 PUSI VERTIKAL


Pozicionuar ne pjesen veriperendimore te sheshit, ne kendin prane godines se Presidences, eshte konceptuar krijimi i nje korridori vertikal per furnizimin e muzeut me artifakte te peshave te renda. Korridori eshte konceptuar duke krijuar tre “kapake” të dedikuara me permasa

- **niveli 0.00** panel me permasa 522x685 cm
- **niveli -4.00** panel me permasa 372x535 cm
- **niveli -7.75** panel me permasa 222x385cm

Në rastet e vecanta kur ne muze duhet te ekspozohet nje artifakt me peshe te madhe, futja e tij do te realizohet me autovinc, duke hapur te tre kapaket perkates. Permasat e tyre vijne duke u zvogeluar, ne menyre qe te mundesojne heqjen e kapakeve nga niveli me I poshtem deri ne kuoten 0.00 te sheshit.

7.2 PAJISJET TEKNIKE TE KONDICIONIMIT


Për shkak të kërkesave teknike specifike, instalimi i impianteve të HVAC është konceptuar të pozicionohet në një hapësirë jashtë sheshit të madh, në hapësirën e gjelbër në krah të godinës së Rektoratit. Ketu do të realizohet një gropë e madhe teknike e cila do të jetë e hapur nga sipër dhe e mbuluar me zgare metalike, duke u mendësuar impianteve ajrimit dhe nevojshëm natyral. Me pas, linjat e ajrimit dhe të kondicionimit do të shtrihen përgjatë tavanit të galerisë nëntokësore të qarkullimit të mjeteve. Përmes dy shafteve vertikale kësaj linje do të mund të aksesohen hapësirat nëntokësore të muzeut.




Pozicionimi i hapësirës teknike të HVAC, në pjesën juglindore të sheshit

7.3 HAPESIRAT TEKNIKE

Jane parashikuar te ndara ne tre kate te posacme, ne pjesen juglindore te sheshit, poshte korridorit te qarkullimit te automjeteve. Ne total llogaritet nje hapësire tre kateshe, me siperfaqe kati bruto prej 375 me dhe siperfaqe totale 1125 m2. Keto hapësira do te aksesohen permes kollones se shkalleve te parkimit ne cepin juglindor te sheshit, e cila, ndryshe nga kollonat e tjera do te mundesoje zbritjen e stafit teknik ne cdo kat teknik. Pervec kesaj, keto kate teknike do te mund te aksesohen edhe permes ashensorit te dedikuar te mallrave.




Organizimi hapësiror I hapësirës së shërbimeve në nivelin -19.00 metra.



Organizimi ne tre kate teknike, poshte galerise se levizjes se mjeteve

Nga pikepamja funksionale, dy katet teknike te siperme do të jene te dedikuara per pjesen administrative dhe funksionale te muzeut arkeologjik. Nderkohe qe kati i poshtem do te jete i dedikuar per hapësirat e depozitave te ujit dhe pompave per te gjithë kompleksin.

Nderkohe, hapësirat poshte shkalleve dhe rampave te zbritjes per ne sheshin e poshtem jane parashikuar per hapësira teknike per instalimet elektrike.



Hapësirat teknike poshte shkalleve dhe rampave per instalimet elektrike

8 XHAMI SI ELEMENT NDARES DHE DEKORATIV

Një nga elementet përcaktuese të konceptit arkitektonik për hapësirat e vendosura nën Sheshin Nënë Tereza është përdorimi i gjerë i fasadave me lartësi të plotë prej xhami. Kjo zgjedhje projektuese shkon përtej konsideratave thjesht estetike dhe përfaqëson një strategji themelore arkitektonike që synon krijimin e lidhjeve të vazhdueshme vizuale dhe hapësirore ndërmjet mjedisit nëntokësor dhe jetës dinamike urbane të sheshit mbi të.

Transparenca e fasadave eliminon perceptimin tradicional të hapësirave nëntokësore si mjedise të mbyllura apo të izoluar. Në vend të kësaj, ajo krijon një ndjenjë hapjeje, përshkueshmërie dhe vazhdimësie vizuale, duke lejuar depërtimin e dritës natyrore thellë në sheshin e zhytur dhe duke ruajtur një marrëdhënie të drejtpërdrejtë vizuale me hapësirën publike përreth. Vizitorët që ndodhen në nivelin e poshtëm mbeten vazhdimisht të lidhur me aktivitetin, lëvizjen dhe atmosferën në ndryshim të sheshit, duke forcuar ndjenjën e orientimit dhe përkatësisë ndaj vendit.

Nga pikëpamja arkitektonike, fasadat prej xhami kontribuojnë në krijimin e një mjedisi bashkëkohor, mikpritës dhe të hapur, duke rritur perceptimin e hapësirës dhe duke siguruar që funksionet nëntokësore të përfitojnë nga ndriçimi natyror dhe aksesueshmëria vizuale. Gjatë orëve të mbrëmjes, ambientet e ndriçuara të brendshme bëhen të dukshme nga niveli i sheshit, duke e



transformuar ndërhyrjen në një element aktiv urban dhe duke përforduar rolin e saj si destinacion kulturor dhe social.

Sheshi i zhytur në kuotën -4.00 m funksionon si hapësira kryesore publike e shpërndarjes, nga e cila vizitorët mund të aksesojnë të gjitha funksionet e propozuara. Duke vepruar si një zgjatim natyror i vetë sheshit, kjo hapësirë qendrore grumbullimi krijon lidhje të drejtpërdrejta me hyrjen dhe hapësirat e pritjes së muzeut arkeologjik, Kapelën e Nënë Terezës, zonën e bar-restorantit, hapësirat edukative dhe kulturore, si dhe funksionet mbështetëse të shërbimit.

Përveç kësaj, sheshi i zhytur shërben si pika kryesore e aksesit drejt bërthamave të qarkullimit vertikal që lidhin nivelet e parkimit nëntokësor. Ashensorët, shkallët dhe korridoret e qarkullimit, të pozicionuara në mënyrë strategjike, sigurojnë lëvizje efikase ndërmjet niveleve të ndryshme të kompleksit, duke garantuar orientim të qartë, aksesueshmëri universale dhe përputhshmëri me standardet e sigurisë.

Përmes këtij sistemi të integruar të hapësirave publike dhe rrugëve të qarkullimit, projekti krijon një marrëdhënie të pandërprerë ndërmjet sheshit, funksioneve kulturore dhe infrastrukturës nëntokësore, duke e transformuar të gjithë ndërhyrjen në një mjedis urban koheziv, funksional dhe të ndërlidhur. Në këtë mënyrë, kufiri ndërmjet sipërfaqes dhe nëntokës zbehet, duke krijuar një përvojë të unifikuar hapësinore që pasuron jetën publike dhe rrit potencialin kulturor e social të Sheshit Nënë Tereza.

9 MUZEU ARKEOLOGJIK


Me një sipërfaqe ekspozimi prej afërsisht 6000 m², hapësira e muzeut organizohet mbi bazën e një rrjete të rregullt strukturore, të formuar nga kolona të vendosura sipas moduleve të përsëritura, duke ofruar një shkallë të lartë fleksibiliteti për organizimin dhe zhvillimin e skenarëve të ndryshëm ekspozues. Hapësira konceptohet si një galeri e madhe me plan të hapur, ku sistemi strukturor integrohet në mënyrë diskrete në kompozimin arkitektonik, duke lejuar që trashëgimia arkeologjike e ekspozuar të mbetet elementi kryesor i përvojës së vizitorit.

Ky konfigurim hapësinor mundëson:

- Ekspozimin e artefakteve arkeologjike me përmasa dhe tipologji të ndryshme;
- Organizimin e ekspozitave të përhershme dhe të përkohshme;
- Krijimin e itinerareve të ndryshme të vizitës dhe narrativave interpretuese;
- Përshtatjen e hapësirës për aktivitete kulturore, edukative dhe ngjarje publike.


Karakterit arkitektonik i muzeut është njëkohësisht minimalist dhe monumental. Në vend që të imponojë praninë e tij ndaj vizitorit, arkitektura vepron si një kornizë neutrale dhe e përrjetshme, e cila përfordcon perceptimin dhe vlerësimin e koleksionit arkeologjik. Përmes kontrollit të kujdesshëm të shkallës, materialitetit dhe përmasave hapësinore, krijohet një atmosferë reflektimi, qetësie dhe zbulimi, ku artefaktet historike marrin rolin qendror brenda mjedisit ekspozues.

Hapësira është projektuar për të ofruar fleksibilitet maksimal në menaxhimin e ekspozitave, duke mundësuar ndryshime të lehta në organizimin e tyre sipas nevojave muzeale dhe programeve kulturore. Rregullsia e rrjetit strukturor siguron qartësi organizative dhe orientim të lehtë për vizitorët, ndërsa planimetria e hapur lejon perceptimin e muzeut si një tërësi e unifikuar, ku rrjedhshmëria e lëvizjes dhe vazhdimësia vizuale luajnë një rol të rëndësishëm në ndërtimin e përvojës së vizitës.




Pamje 3d e propozuar për hapësirën muzeale

Në këtë mënyrë, muzeu nuk paraqitet thjesht si një hapësirë ekspozimi, por si një mjedis kulturor bashkëkohor që krijon kushtet optimale për interpretimin, ruajtjen dhe prezantimin e trashëgimisë arkeologjike, duke ndërtuar një urë lidhëse ndërmjet historisë së lashtë dhe publikut të sotëm.



Një nga elementet më dalluese të konceptit arkitektonik të muzeut arkeologjik është seria e planeve vertikale që shtrihen nga niveli nëntokësor i ekspozimit deri në sipërfaqen e Sheshit Nënë Tereza. Këto elemente e tejkalojnë rolin e tyre funksional si struktura mbajtëse ose kufij hapësinorë, duke u shndërruar në komponentë përcaktues të identitetit arkitektonik të projektit.



Prerje tërthore e propozuar e strukturës,

Akresi në muze sigurohet përmes një bërthame të madhe qarkullimi vertikal që përmban tre ashensorë. Duke u ngritur nga galeritë e muzeut në nivelet e poshtme dhe duke arritur deri në hapësirën publike sipër, planet vertikale krijojnë një lidhje të drejtpërdrejtë fizike dhe vizuale ndërmjet botës arkeologjike nën shesh dhe jetës bashkëkohore urbane në nivelin e tokës. Prania e tyre zbulon ekzistencën e muzeut poshtë, ndërsa krijon një gjest të fuqishëm arkitektonik që pasuron kompozimin hapësinor të sheshit.

Sipërfaqet vertikale shërbejnë për qëllime të shumta: ato sjellin dritë natyrore në zona të përzgjedhura të muzeut, lehtësojnë orientimin vizual brenda hapësirave nëntokësore dhe kontribuojnë në cilësinë mjedisore të zonave të ekspozimit. Në shkallë urbane, ato krijojnë një ritëm elementesh arkitektonike që artikulojnë hapësirën e hapur të sheshit dhe gjenerojnë momente zbulimi dhe ndërveprimi.


Të ndërtuara me të njëjtën paletë materiale prej guri natyror dhe betoni arkitektonik të përdorur në të gjithë projektin, këto plane vertikale përforcojnë vazhdimësinë materiale të ndërhyrjes dhe evokojnë qëndrueshmërinë dhe soliditetin e lidhur me trashëgiminë arkeologjike. Shprehja e tyre monolitike kujton shtresëzimin e historisë dhe daljen në sipërfaqe të kujtesës kulturore nga nëntoka, duke e transformuar një domosdoshmëri funksionale në një element të fuqishëm simbolik dhe arkitektonik.

Faqet vertikale krijojnë një tranzicion të qartë ndërmjet dy realiteteve urbane:

- niveli i sipërm, i cili përfaqëson qytetin bashkëkohor dhe jetën e përditshme publike;

- niveli i poshtëm, ku ekspozohen kujtesa historike dhe trashëgimia arkeologjike.

Ato funksionojnë si një “prerje” në trupin e sheshit, duke bërë të dukshme shtresat e fshehura të territorit dhe duke materializuar konceptin e qytetit si një organizëm i ndërtuar mbi historinë e vet.



10 KONCEPTI STRUKTUROR

Koncepti strukturor i ndërhyrjes në Sheshin Nënë Tereza është zhvilluar mbi parimin e krijimit të një infrastrukture nëntokësore me hapësira të mëdha të lira, duke ruajtur njëkohësisht karakterin monumental dhe funksionimin e pandërprerë të sipërfaqes së sheshit. Struktura konceptohet si një sistem i integruar që bashkon parkimin nëntokësor, muzeun arkeologjik, kapelën e Nënë Terezës dhe hapësirat publike të sipërme në një organizëm të vetëm ndërtimor.



Koncepti strukturor bazohet në idenë e “arkitekturës së fshehur”, ku struktura nuk synon të shfaqet si element dominues, por të krijojë kushtet që sipërfaqja publike të mbetet e lirë, e hapur dhe monumentale. Në këtë projekt, struktura nuk është vetëm një sistem mbajtës, por instrumenti që mundëson bashkëjetesën e tre niveleve funksionale:

- Sheshi publik dhe shatërvanët në sipërfaqe;
- Muzeu arkeologjik, kapela dhe hapësirat publike në nivelin e parë nëntokësor;
- Parkimi nëntokësor dhe funksionet teknike në nivelin e poshtëm.

Kështu, e gjithë ndërhyrja funksionon si një strukturë urbane e vetme dhe shumështrësore, ku sistemi strukturor bëhet elementi që lidh historinë, kulturën, mobilitetin dhe jetën publike në një organizëm arkitektonik të integruar.

Pllaka e sipërme prej betoni të armuar shërben si element mbulues me kapacitet të lartë mbajtës, mbi të cilin zhvillohet i gjithë aktiviteti i sheshit. Kjo pllakë duhet të përballojë:

- Ngarkesat e këmbësorëve;
- Ngarkesat e aktiviteteve publike dhe ceremoniale;
- Peshën e shatërvanëve dhe elementeve të peizazhit;
- Ngarkesat e automjeteve të mirëmbajtjes dhe emergjencës;
- Veprimet sizmike sipas kushteve gjeoteknike të zonës.

Në këtë mënyrë, sipërfaqja e sheshit perceptohet si një terren urban i vazhdueshëm, ndërsa funksionet kryesore zhvillohen nën të.

10.1 SISTEMI KOLONË–TRA–PLLAKË

Skemat e muzeut dhe të parkimit zbulojnë një rrjet strukturor të rregullt të bazuar në:

- Kolona prej betoni të armuar;
- Trarë kryesorë dhe dytësorë;
- Pllaka monolitike ose pllaka me pas-tensionim.

Ky rrjet modular krijon fleksibilitet të lartë funksional dhe mundëson organizimin e hapësirave të mëdha pa pengesa vizuale. Në muze, ritmi i kolonave krijon një strukturë të lexueshme dhe monumentale, ndërsa në parkim ai mundëson organizimin racional të vendeve të parkimit dhe korsive të qarkullimit.

10.2 MURET PËRIMETRALE MBAJTËSE

Për shkak të thellësisë së konsiderueshme të gërmimit, struktura mbështetet nga mure perimetrale prej betoni të armuar, të cilat kanë një funksion të dyfishtë:



- Mbajtjen e presionit horizontal të dheut;
- Krijimin e kufirit hidroizolues të kompleksit.

Këto mure formojnë një “kuti strukturore” të ngurtë, e cila punon së bashku me pllakën e poshtme dhe pllakën e sipërme për të garantuar stabilitetin e përgjithshëm të objektit.

10.3 HAPËSIRAT VERTIKALE SI ELEMENTE STRUKTURORE

Faqet vertikale që lidhin muzeun me sipërfaqen e sheshit nuk kanë vetëm një rol arkitektonik. Ato mund të funksionojnë si elemente të rëndësishme strukturore që:

- Transmetojnë ngarkesat drejt themeleve;
- Rrisin ngurtësinë e sistemit;
- Kontribuojnë në rezistencën sismike të ndërtesës.

Në këtë mënyrë, elementet që perceptohen si pjesë e kompozimit arkitektonik bëhen njëkohësisht pjesë e sistemit mbajtës të strukturës.

10.4 INTEGRIMI I INFRASTRUKTURËS TEKNIKE

Koncepti strukturor është projektuar që në fillim në koordinim me sistemet teknike të ndërtesës. Hapësirat ndërmjet trarëve dhe pllakave mundësojnë integrimin e:

- Sistemeve HVAC;
- Sistemeve të ventilimit të parkimit;
- Sistemeve të mbrojtjes nga zjarri;
- Rrjeteve elektrike dhe të komunikimit;
- Sistemeve të drenazhimit dhe hidroizolimit.

Kjo shmang ndërhyrjet e mëvonshme dhe ruan pastërtinë dhe qartësinë e hapësirave muzeale.

11 GURI SI MATERIAL DOMINUES


Veshja me gur natyror propozohet si një nga elementet kryesore të identitetit material të projektit të muzeut arkeologjik, duke krijuar vazhdimësi ndërmjet sipërfaqeve horizontale të sheshit, mureve vertikale dhe hapësirave të zhvilluara nën nivelin ± 0.00 . Përdorimi i gurit synon të japë një karakter monumental, të qëndrueshëm dhe të përmbajtur, në harmoni me arkitekturën institucionale që rrethon sheshin.

Propozohen pllaka guri natyror, me strukturë kompakte dhe me rezistencë të lartë ndaj ngarkesave mekanike, cikleve ngrirje–shkrirje, lagështisë dhe ndryshimeve termike. Ngjyra do të jetë neutrale dhe relativisht uniforme, në tonalitete bezhë, gri të ngrohtë ose krem, në mënyrë që të ruhet qetësia

vizuale e kompozimit. Ndryshimet natyrore të tonalitetit janë të pashmangshme, por panelet duhet të seleksionohen paraprakisht për të shmangur kontraste të forta ndërmjet elementeve ngjitur.

Guri i përdorur duhet të karakterizohet nga:

- porozitet dhe përthithje e ulët e ujit;
- rezistencë e lartë në përkulje dhe shtypje;
- qëndrueshmëri ndaj ndotjes atmosferike dhe rrezatimit UV;
- rezistencë ndaj kripërave dhe agjentëve të pastrimit;
- homogjenitet strukturor, pa çarje, vena të dobëta ose defekte të dukshme;
- mundësi mirëmbajtjeje dhe zëvendësimi të elementeve individuale.



Për sipërfaqet vertikale rekomandohet një përpunim mat, i lëmuar lehtë ose i honuar, i cili evidenton karakterin natyror të materialit pa krijuar reflektime të forta. Në zonat pranë nivelit të këmbësorëve mund të përdoret një përpunim pak më i ashpër, më rezistent ndaj goditjeve dhe ndotjes. Panelet do të organizohen në module të mëdha, me dimensione 120 × 250 cm, duke iu përshtatur ritmit të fasadës, fugave arkitektonike dhe pozicionit të elementeve strukturore.



11.1 NËNSTRUKTURA METALIKE

Nënstruktura do të realizohet me profile vertikale dhe horizontale prej çeliku të galvanizuar në të nxehtë. Profilet duhet të dimensionohen për peshën vetjake të gurit, ngarkesat e erës, deformimet termike dhe veprimet sizmike. Lidhjet duhet të lejojnë dilatimin e kontrolluar të strukturës pa transmetuar tensione të panevojshme te guri.



Rr.Fadil Rada, p.Daniela, shk.2, k. 3, ap.9, Tiranë
Cel. +355(0)694058048
e-mail : studiotower07@gmail.com

Rr.Fadil Rada, p.Daniela, shk.2, k. 3, ap.9, Tiranë
Cel. +355(0)694058048
igroup.al@gmail.com



Panelet do të fiksohen me ankera metalike ose elemente të posaçme të vendosura në kanale të realizuara në gur. Çdo panel duhet të ketë pika mbajtëse dhe pika stabilizuese. Elementet mbajtëse transmetojnë peshën vertikale të panelit në nënstrukturë, ndërsa elementet stabilizuese kontrollojnë lëvizjen horizontale dhe veprimin e erës. Nuk rekomandohet që pesha e panelit të transmetohet te paneli i poshtëm.

Për panelet me përmasa dhe peshë të madhe duhet të parashikohet edhe një sistem sekondar sigurie, i cili pengon shkëputjen ose rënien e elementit në rast dëmtimi të ankorimit kryesor.





11.2 KONTROLI DHE MIRËMBAJTJA


Përpara prodhimit masiv duhet të realizohet një mock-up në shkallë reale, ku të verifikohen tonaliteti, tekstura, përmasat e fugave, mënyra e ankorimit, detajet e qosheve dhe sjellja e materialit ndaj ujit. Pas montimit duhet të kryhen kontrole periodike të:

- ankorimeve dhe lidhjeve metalike;
- çarjeve ose dëmtimeve të gurit;
- fugave dhe pikave të drenazhimit;
- korrozionit të mundshëm;
- qëndrueshmërisë së paneleve

Në këtë mënyrë, veshja me gur nuk trajtohet vetëm si përfundim estetik, por si një sistem i plotë konstruktiv, i projektuar për jetëgjatësi, siguri dhe përshtatje me kushtet e veçanta të një hapësire publike me përdorim intensiv.

12 SIPËRFAQE E PROJEKTIMIT – PROJEKT IDE PERFUNDIMTARE

Kuota	Sipërfaqe
Niveli ± 0.00 (siperfaqe e sheshit)	12.500 m ²
Niveli – 4.00 m	3495 m ²
Niveli – 7.75 m	11,892 m ²
Niveli – 19.00 m	6,691 m ²
Total	22,078 m²





Rr.Fadil Rada, p.Daniela, shk.2, k. 3, ap.9, Tiranë
Cel. +355(0)694058048
e-mail : studiotower07@gmail.com

Rr.Fadil Rada, p.Daniela, shk.2, k. 3, ap.9, Tiranë
Cel. +355(0)694058048
igroup.al@gmail.com





Rr.Fadil Rada, p.Daniela, shk.2, k. 3, ap.9, Tiranë
Cel. +355(0)694058048
e-mail : studiotower07@gmail.com


Rr.Fadil Rada, p.Daniela, shk.2, k. 3, ap.9, Tiranë
Cel. +355(0)694058048
igroup.al@gmail.com





Rr.Fadil Rada, p.Daniela, shk.2, k. 3, ap.9, Tiranë
Cel. +355(0)694058048
e-mail : studiotower07@gmail.com

Rr.Fadil Rada, p.Daniela, shk.2, k. 3, ap.9, Tiranë
Cel. +355(0)694058048
igroup.al@gmail.com



Përgatitur nga:

TOWER SH.P.K. & iGROUP SH.P.K.